



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M
Nr. 85, datë 12.12.2024

PËR

"MIRATIMI I NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË
PAGAVE TË BASHKISË GJIROKASTËR PËR VITIN 2025"

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar Ligji 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM- së nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", Ligjit Nr. 7961/1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, Ligjit nr. 35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", Ligjit nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", Vendimit Nr. 514, Datë 20.9.2017 "Për Miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve (Lkp)", të rishikuar, Vendimit nr. 113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", VKM nr. 425, datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në Institucionet arsimore dhe në Institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar", VKM nr. 419, datë 26.06.2024 "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Vendimit nr. 503, datë 01.08.2024 Për disa ndryshime në Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM -së nr. 421, datë 26.06.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të Zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunës civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike," të ndryshuar", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 113, datë 14.12.2023 "Për miratimin e PBA 2024- 2026 dhe buxhetit vjetor 2024", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 107, datë 14.12.2023 "Për Miratimin e numrit maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2024", Projektit "Ofrimi i Shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Gjirokastrë", Aplikimit

prot., datë 20.05.2019 për Fondin Social, Njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 5144 prot., datë 29.10.2019 si dhe në Manualin Orientues "Për implementimin e strukturave dhe organikave në njësitë e vetëqeverisjes vendore".



VENDOSI:

1. Të miratohet numri maksimal i punonjësve prej 641 (gjashtëqind e dyzet e një), për vitin 2025.
2. Të miratohen nivelet e pagave (klasat, kategoritë dhe grupet) sipas aneksit nr.1, bashkëlidhur.
3. Për zbatimin e këtij urdhri të ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Arkivës dhe Protokollit, dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky urdhër hyn në fuqi 10 ditw pas shpalljes!

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETARI I KËSHILLIT

